




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 03-02-DPK Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages 02	Nr. Prot. Br. Prot. 01-114/16 Prot No. Data Datum 13. 01. 2016 Date PRISHTINË



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.01.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-4294-15, për Zyrtarin e lartë, z.Taib Alidemi–Këshilltar Komunal në Viti, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-4294-15, për Zyrtarin e lartë, z.Taib Alidemi–Këshilltar Komunal në Viti, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Alidemi është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai ka kontaktuar zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Alidemi është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell informatën mbi biznesin (DPK/DPKI-03-02-47/16), nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilat shihet se te biznesi individual, Ordinanca Specialistike e Mjekësisë Familjare O.S. "Doza", dhe N.Sh. "Syri", z.Alidemi tashmë ka hequr dorë nga e drejta e të qenurit person i autorizuar, duke emëruar në këtë pozitë një person të besuar, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Hasan Preteni /

